



Gjysem Maratona e Tiranës 09/10/2016

- **Luiza Gega thyen rekord kombetar ne Gjysem Maratonen e Tiranës.**

Paraditen e djeshme per me shume se 3 ore u zhvillua ne kryeqytetin e Shqiperise "1/2 Maratona e Tiranës". Nen kujdesin e Bashkise se Tiranës dhe Federates Shqiptare te Atletikes u mbajt ne kryeqytet ky aktivitet ku me shume se 1200 pjesemarres garuan ne 4 kategori per grupmosha te ndryshme.Federata Shqiptare e Atletikes u perfaqesua nga presidenti i saj z.Gjergj Ruli si dhe Sekretari i Pergjithshem z.Nikolin Dionisi te cilet do te paraqiten ne Konventen Nderkombetare te Europes ne Funchal te Portugalise per te regjistruar "Maratonen e Tiranës" ne kalendarin e aktiviteve nderkombetare.Krahas krereve te Federates Shqiptare te Atletikes nuk munguan ne pershendetjen e garuesve kryetari i Bashkise z.Erjon Veliaj, ministrja e Arsmite dhe Sportit znj.Lindita Nikolla,kryetarja e komunes Gjakove znj. Mimoza Kusari Lila,Presidenti i Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar z.Viron Bezhani si dhe drejtori i Sportit prane MAS z.Vladimir Gjonaj.

Nderkohe fitues i gares per 21km per meshkuj doli korcari Ilir Kellezi, ndersa per femra fituese u shpall rekordmenia shqiptare Luiza Gega. Ndersa ne garen e 10 km u shpall fitues Bledar Mesi, i cili vinte si perfaqesues i Forcave te Armatosura. Ne kete kategori garoi dhe kryetari i bashkise Erjon Veliaj si dhe personalitete te tjere te rendesishem.Fituesi i gares per 21 km Ilir Kellezi tha se ishte i gezuar qe ishte fituesi i pare i Maratones se Tiranës dhe shpresoj qe vitin tjeter te kete me shum pjesemarres e konkurrenca te jete me e madhe.

Gjate zhvillimit te 1/2 Maratones se Tiranës ne daten 09/10/2016, atletja Luiza Gega eshte shpallur fituese ne garen e 21 km per femra. Luiza Gega njekohesisht ka vendosur dhe rekord te ri kombetar ne kete gjysem maratone me rezultatin 1:22:08 kundrejt rekordit qe mbahej nga Miranda Greca me kohen 1:25:40 ne vitin 1974 ne gjysem maratonen e zhvilluar ne Prishtine. Ne perfundim te gares Luiza Gega e analizoi eventin: "U kenaqa shume, vrapova per qejf dhe e shijova shume garen. Shpresoj shume qe Tiranës dhe gjithe Shqiperise te mos i mungojne te tilla organizime".

